



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:103168

Datë: 16.02.2021

Numri i dokumentit: 01510873

PA1.nr.1040/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKTA E APELIT E KOSOVES – Departamenti i përgjithshëm, kolegji i përberë nga gjyqtaret Ferit Osmani kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku ,dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Ahmeti, procesmbajtës, ne çështjen penale kundër të akuzuarit L.R., nga fshati ..., Komuna e Drenasit, për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë në tentativë, nga neni 315 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 28 të KPK dhe veprës penale pengimi i personit zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.4 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit L.R., av.Shemsi Uka, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, P.nr 1531/2020, të datës 21.09.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15.02.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit L.R., av.Shemsi Uka, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, P.nr 1531/2020, të datës 21.09.2020, **vërtetohet**.

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, P.nr 1531/2020, të datës 21.09.2020, është shpallur fajtor i akuzuari L.R., për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë në tentativë, nga neni 315 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 28 të KPK dhe veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.4 të KPK, ashtu që për veprën e parë penale i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti, si dhe dënimi me gjobë, në shumën prej 500Euro, kurse për veprën e dytë penale i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë)muajve, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në kuptim të nenit 76 par.1 lidhur me par.2 nën par.2.2 të KPK, për të dy veprat penale për të cilat i është shqiptuar dënimi me burgim i shqiptohet dënim ime burgim unik në kohëzgjatje prej 1 (një)viti e 3(tre) muajve.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë dënimin e shqiptuar me gjobë, i njëjti do ti zëvendëset në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 25 ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20Euro, në kuptim të nenit 43 par.3 të KPK.

Koha e kaluar në paraburgim nga dt.30.07.2020, gjerë me dt.28.08.2020, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim, në kuptim të nenit 79 të KPK.

Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, paushallin gjyqësor në shumën prej 20Euro, si dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 30 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të dëmtuarit për realizmin e kërkesës pasurore juridike, janë udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit L.B., av.Shemsi Uka, për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe dënimi i shqiptuar me burg, të kushtëzohet.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me parashtresën PPA/II.nr.1053/2020, të datës 20.01.2021, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit L.B., av.Shemsi Uka, ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.15.02.2021, dhe i ka njoftuar në mënyrë të rregullt të gjitha palët nga shkresat e lëndës. Në seancë të kolegjit, kanë prezantuar mbrojtësi i të akuzuarit L.R., av.Shemsi Uka, i dëmtuari V.G. dhe i dëmtuari A.R., kurse palët e tjera nuk kanë prezantuar, përkundër asaj që janë njoftuar me rregull, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit L.B., av.Shemsi Uka, nuk është e bazuar

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit L.B., av.Shemsi Uka, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë pasi që të akuzuarin e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë në tentativë, nga neni 315 par.1 nën par.1.1 dhe veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.4 të KPK, të njëjtit për secilën veprë penale i ka shqiptuar dënim me burgim, dhe atë për veprën e parë penale, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti, si dhe dënimin me gjobë në shumën prej 500(pesëqind)Euro, kurse për veprën e

dytë penale i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6(gjashtë)muajve. Në kuptim të dispozitave përkatëse ligjore i ka shqiptuar dënimin me burgim unik në kohëzgjatje prej 1(një)viti e 3(tre)muajve, në të cilin i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga dt.30.07.2020, gjerë me dt.28.08.2020, mirëpo, je3mi të bindur se në këtë çështje penale i akuzuari ka pasur shumë rrethanat lehtësuese në anën e vet, duke filluar nga pranimi i fajësisë për veprat penale të cilat i ka kryer, se i njëjti është penduar thellësisht dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk ka me kryer vepra të tjera penale, se është mbajtës i familjes, i gjendjes së varfër ekonomike, se motrën dhe prindërit i ka të sëmur, që nënkupton se janë të gjendjes së rëndë shëndetësore, se ka kërkuar falje nga të dëmtuarit, andaj në prani të këtyre rrethanave ka propozuar që ti shqiptohet dënimi me kusht me të cilin do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar nga na e mbrojtësit së të akuzuarit L.B., av.Shemsi Uka, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljet e ligjit penal, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila është vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale e cila i vihen në barrë, e gjithashtu gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe rrethanat lehtësuese, sikurse edhe ato rënduese, ashtu që me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 të KPK, ashtu që si rrethana lehtësuese ka vlerësuar se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ka pasur sjellje korrekte në gjykatë, se ka shprehur keqardhje për veprat penale të kryera, se ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e intensitetit të së njëjtës, andaj, kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar edhe ankesën e ushtruar nga e mbrojtësit së të akuzuarit L.B., av.Shemsi Uka, nga e cila nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, ashtu që në prani të këtyre rrethanave, kolegji është i bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.1040/2020, të datës 15.02.2021

Bashk.profesional
Bujar Ahmet

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Zyhdi Haziri